

Emërtimi i lëndës		KIMI MJEDISI		KODI (KIM 480)
Viti		I		
Semestri		II		
Vendin që zë lënda në formimin tërësor të studentit		Lëndë të detyrueshme / Disiplina të formimit karakterizues		
Përshkrimi		Qëllimi kryesor i lëndës "Kimi Mjedis" është studimi i ajrit, ujit dhe tokës, si kanë ndikuar aktivitetet antropogjenë në planetin Tokë. Konkretisht analizohen burimet, reaksionet, transporti, ndikimi dhe fati i specieve kimike në ajër, tokë, ujë dhe ndikimi i teknologjisë në to. Kjo lëndë përfshin pesë pjesë kryesore: (1) kimia e atmosferës dhe ndotja e ajrit; (2) ndryshimet klimaterike dhe energjike; (3) kimia dhe ndotja e ujit; (4) komponimet organike toksike; (5) metalet, toka, sedimentet dhe shkarkimet e mbetjeve.		
Ngarkesa në orë	Në auditore	60 orë		
	Jashtë auditorit	90 orë		
Kreditet		6 ECTS = 150 orë		
Format e mësimdhënies		Kredite (ECTS)	Auditor (orë)	Studim (orë)
	Gjithësej	6	60	90
Temat që do trajtojnë lënda në formimin teorik 30 orë leksione		<ol style="list-style-type: none"> Hyrje në Kiminë e Mjedisit. Kimia e atmosferës. (1 orë) Kimia e Stratosferës. Vrima e ozonit", shkaqet dhe pasojat e pakësimit të përmbajtjes së ozonit në stratosferë. (1 orë) "Kimia e Troposferës. Efekti "serë". (1 orë) Shiu acid. Smogu fotokimik. (1 orë) Monoksidi i karbonit dhe substancat e tjera ndotëse në ajër. (1 orë) Njohuri bazë mbi strategjinë e monitorimit të ndotjeve të ajrit dhe kiminë analitike të ndotjeve të ajrit. (1 orë) Kimia e ujërave natyrore. Elementët ushqyes në ujra, gjendja eutrofike e ujërave. (1 orë) Uji i pijshëm, trajtimet e ujit të pijshëm. Ujërat detare. (1 orë) Elementët kryesorë dhe elementët gjurmë në ujërat detare. (1 orë) Ndotjet dhe dëmtimet e mjedisve detare. (1 orë) Njohuri mbi monitorimin mjedisor të ujërave dhe analizat kimike. Kimia e tokës. (1 orë) Ndotjet dhe dëmtimet e tokës nga shkaqe urbane dhe erozioni, regjenerimi i tokave. (1 orë) Njohuri mbi metodat e monitorimit dhe analizave kimike të tokës. (1 orë) Kimia e mjedisit e mbeturinave të rrezikshme. (1 orë) Pakësimi, trajtimi dhe depozitimi i mbeturinave të rrezikshme. Mbeturinave të ngurta urbane. (1 orë) Trajtimi i mbeturinave të lëngeta urbane. Substancat organike në mjedis, klasifikimi. (1 orë) Substancat organike në atmosferë. (1 orë) Substancat organike fluore, metani dhe hidrokarburet e tjera fluore, gazet e djegies së automjeteve. (1 orë) Derivatet e halogjenuara të hidrokarbureve, aftësia ozonholluese, freonet, halonet, alternativat e tjera. (1 orë) Substancat organike pak fluore, arenet policiklike aromatike (PAH). Poliklorbifenilet (PCBte). (1 orë) Poliklordibenzodioksinat (PCDD), poliklordibenzofuranet (PCDF). (1 orë) Substancat organike ndotëse në mjedisin ujor. Substancat 		

	<p>tensioaktive, fenolet, etj. (1 orë)</p> <p>23. Pesticidet, substanca organike nga industria kimike, komponimet organike te merkurit dhe te kallajit. (1 orë)</p> <p>24. Bioakumulimi dhe bioshufeshimi i ndotësave organike në zinxhirin ushqimor. Substancat organike ndotëse në tokë. (1 orë)</p> <p>25. Persistenca dhe degradimi i ndotësave organike. Nociione bazë për ekologjinë. (1 orë)</p> <p>26. Nociione bazë të toksikologjisë. (1 orë)</p> <p>27. Reaksionet e substancave ksenobiote, teratogjeneza, mutagjeneza, kancerogjeneza dhe dëmtimi i sistemit imunitar. (1 orë)</p> <p>28. Metodatat analitike moderne të analizimit të ndotësave organike në mjedis. (1 orë)</p> <p>29. Gazkromatografia, kromatografia e fazës së lëngët, metodatat e çiftëzuara. (1 orë)</p> <p>30. Normat europiane dhe kombëtare të mbrojtjes të mjedisit dhe të trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve të rrezikshme organike. (1 orë)</p>
--	--